



**BASHKIA MIRDITË  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 742 Prot.

Rrëshen më, 20 . 02 . 2024.

**Mbledhja nr. 02 / 2024.**

Lënda: Njoftim për Thirrjen e mbledhjes, së Këshillit Bashkiak Mirditë.

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

**Të nderuar këshilltarë,**

Në mbështetje të nenit 53, pikat 2 dhe 4, neni 56, pika 2, shkronja "a", e ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 56, 57 & 58, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkisë Mirditë, njofton thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ditën e **Hënë, datë 26. 02. 2024, ora 11<sup>00</sup>**, në bashkinë Mirditë, **në transmetim Online në Facebook**, me këtë rend dite;

1. **P/Vendim nr. 620/1, prot.** i Kryetarit Bashkisë; "Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në **6%**, për periudhën **01 – 31 Janar 2024**", bashkia Mirditë.
2. **P/Vendim nr. 652/1 , prot.** i Kryetarit Bashkisë; "Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondine bashkisë, për periudhën **01-31 Janar 2024**", bashkia Mirditë.
3. **P/Vendim nr. 563, prot.** i Kryetarit Bashkisë; "Për trajtimin me bursë shteti për nxënësit e shkollave të mesme dhe të arsimit të mesëm profesional, viti I-rë, (jashtë rrethit), për vitin shkollor 2023-2024", bashkia Mirditë.
4. **P/Vendim nr. 656/1 , prot.** i Kryetarit Bashkisë; "Për miratimin e anëtarësimit në Grupin Vendor të Veprimit (GVV), në zonën rurale të bashkisë Mirditë dhe miratimin në parim të marrëveshjes së partneritetit si bashkëthemelues dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për firmosjen e marrëveshjes së partneritetit".
5. **P/ Vendim nr. 653/1 prot,** i Kryetarit Bashkisë; "Mbi shqyrtimin e kërkesave, të shoqërive "One Albania sha" dhe "Vodafone Albania" sha, për amendim/rinovim dhe prishje të njëanëshme të kontratave me bashkinë Mirditë".
6. **P/ Vendim nr. 654/1 prot,** i Kryetarit Bashkisë; "Për miratimin e propozimit për dhënie me kontratë qiraje, të fondit pyjor/kullor në administrim të bashkisë Mirditë, në funksion të ushtrimit të veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet, kullotat dhe livadhet, për vitin kalendarik 2024", bashkia Mirditë.
7. **P/ Vendim nr. 708 prot,** i Kryetarit Bashkisë; "Për përdorim fond rezervë", bashkia Mirditë.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

8. P/ Vendim nr. 709. prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit, të vitit 2023 ”, bashkia Mirditë.
9. P/ Vendim nr. 710/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e tabelave të situatës financiare të bashkisë, deri me datë 31.12.2023”, bashkia Mirditë.
10. P/ Vendim nr. 711/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e sasisë së konsumit të karburantit për automjetet, drejtoritë, agjencitë dhe njësitë administrative të bashkisë Mirditë”.
11. P/ Vendim nr. 712/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të parcelave të ndodhura në zonën kadastrale 3224, me sipërfaqe prej 42 498 m<sup>2</sup>, (4. 2498 ha), e llojit tokë truall dhe trotuar, nga ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkinë Mirditë, për ndërtimin e stacionit zjarrëfikës të bashkisë Mirditë”.
12. P/ Vendim nr. ~~726~~ prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e fondeve të trshëguara nga buxheti i vitit 2023 për vitin 2024”, bashkia Mirditë.
13. P/ Vendim nr. ~~744~~ prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond i mbrojtjes civile”, bashkia Mirditë
14. P/ Vendim nr. ~~729~~ prot, i Kryesisë Këshillit Bashkiak “Për zgjedhjen e Anëtarëve të Kryesive dhe Kryetarët e Fshatrave të bashkisë Mirditë.
15. P/ Vendim nr. 374/1 prot, i Kryesisë Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Integritimit Evropian”, Këshilli Bashkiak Mirditë (projekt i mbartur nga mbledhja e datës 31. 01. 2024).

Të ndryshme

**KOMISIONI I BUJQËSISË DHE SHËNDETIT PUBLIK (VETERINARISË, MJEDISIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PYJEVE, MENAXHIMIT TË UJRAVE, MBROJTJES SË MJEDISIT DHE BIODIVERSITETIT :**

**E hënë, datë 19. 02. 2024, ora 10 : 00.**

Florenc GJONAJ - kryetar, Fran NDREJAJ - Zv.kryetar, (vakant), Leonard LLESHAJ dhe Arben LEKGEGAJ - anëtarë, do shqyrtohen -↓

- Pikën; 4, 5 dhe 6, të rendit të ditës.

**KOMISIONI I EKONOMISË, FINANCAVE, BUXHETIT, PASURIVE BASHKIAKE, PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK TË BASHKISË DHE MBIQYRJES FINANCIARE:**

**E hënë, datë 19. 02. 2024, ora 14 : 00.**


Ertor NDREU - kryetar, Fran NDREJAJ - Zv.kryetar, Aleksandër LUSHA, Albina VUKA, Brixhilda NOKA , Silva GJOMARKAJ dhe Leonard LLESHAJ - anëtarë, do shqyrtohen -↓

- Pikat 7, 8, 9, 10, 12 dhe 13 të rendit të ditës.

  
Konc. Jurist Gaspër TOPOLLAJ  
Sekretar Këshillit Bashkiak



**KRYETAR**  
**Aleksandër PICA KU**



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN